



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

KONKURRENCA NË SHQIPËRI



Ky botim është financuar nga BE në kuadër të projektit
të asistencës teknike Europe/Aid/128366/C/SER/AL
"Mbështetje për Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës
dhe Departamentin e Ndihmës Shtetërore"

BROSHURË INFORMUESE

A stylized illustration of a diverse group of people, mostly in business attire, standing in a crowd. The figures are simplified, with no facial features, and are rendered in various colors like blue, pink, grey, and yellow. They are arranged in a way that suggests a group of professionals or a public gathering.

KONKURRENCA NE SHQIPERI

Botuar nga:

Autoriteti i Konkurrencës

Përgatitën:

Pajtim Melani, Ermal Nazifi, Ardita Shehaj, Miklovana Ymerali

Përgatitja grafike:

Erald Lamja

Vignette Marketing Agency

KUJDES: Ky material është hartuar nga Autoriteti Konkurrencës me qëllim informimin e publikut mbi të drejtën e konkurrencës dhe zbatimin e tij në Shqipëri. Ai nuk i drejtohet specialistëve të konkurrencës dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore apo detyruese për Autoritetin e Konkurrencës.

Tiranë, Nëntor 2011.

Hyrje

Në një treg të lirë, biznesi është si një lojë ku duhet të konkurrosh. Por, ndonjëherë ndërmarrjet mund të tundohen që të shmangin konkurrencën ndërmjet tyre e të përcaktojnë rregullat e “tyre” të lojës.

Ndonjëherë një “lojtar” i rëndësishëm në treg mund të përpiqet që të nxjerrë, pak nga pak, konkurrentët nga tregu ose të pengojë hyrjet e konkurrentëve të rinj në treg.

Autoriteti i Konkurrencës është si një arbitër që vëzhgon dhe ndërhyr nëse lojtarët nuk realizojnë një lojë të barabartë në treg.



Historiku i së drejtës së konkurrencës në Shqipëri

Baza ekonomike e lindjes dhe e funksionimit të së drejtës e konkurrencës në Shqipëri ka filluar të zbatohet vetëm pas ndryshimit të sistemit politik dhe dhe vendosjes së ekonomisë së tregut, në fillimin e viteve 90.

Megjithatë ligji i parë për mbrojtjen e konkurrencës është miratuar më 7 dhjetor 1995, Ligji Nr. 8044 “Për Konkurrencën”. Me miratimin e këtij ligji fillon periudha e institucionalizimit të së drejtës së konkurrencës në vendin tonë. Miratimi i ligjit “Për Konkurrencën”, mundësoi ngritjen e strukturës së parë për konkurrencën, atë të Drejtorisë së Konkurrencës Ekonomike pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, si dhe Komisioni i Konkurrencës, i cili përbëhej nga pesë anëtarë, të emëruar nga Ministri që mbulonte Tregtinë. Ligji trajtonte çështjet që lidhen me monopolet, pozicionin dominues, si dhe ato të konkurrencës së pandershme.

Gjatë zbatimit të tij u ndeshën një sërë problemesh që nuk kishin gjetur zgjidhje në këtë ligj. Kështu, u bë e qartë nevoja për ndryshime ligjore dhe institucionale në fushën e konkurrencës. Me gjithë zhvillimet e së drejtës së konkurrencës, u konstatua se legjislacioni përkatës kishte mangësi dhe ishte larg legjislacionit, institucioneve dhe Politikave të Konkurrencës të BE-së. Për të plotësuar këtë boshllëk u miratua ligji 9121, datë 28.07.2003. “Për mbrojtjen e konkurrencës”¹.

¹ Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” wshtw ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.04.2006; Ligjin Nr. 9584 datë, 17. 07. 2006, si dhe Ligjin Nr. 10 317, datë 16.09.2010.

Kush e zbaton ligjin për mbrojtjen e konkurrencës?

Autoriteti i Konkurrencës është institucioni publik i ngarkuar nga ligji, për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në Shqipëri. Ky institucion ka për qëllim të mbrojë konkurrencën në vetvete, si një e mirë publike. Në këtë mënyrë mbrojtja e konkurrencës efektive i shërben interesit publik. Ky ligj është i zbatueshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe për të gjitha ndërmarrjet, private dhe shtetërore, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për ndërmarrjet që veprimtarinë e ushtrojnë jashtë këtij territori, por pasojat e saj ndihen në tregun e brendshëm.

Puna e Autoritetit të Konkurrencës mbështetet në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

- marrëveshjet e ndaluara (kartelet);

- abuzimin me pozitën dominuese;
- bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve.

Një tjetër detyrë e këtij institucioni është të veprojë si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, si dhe të vlerësojë aktet normative të ndryshme që mund të cenojnë konkurrencën.

Një aspekt i rëndësishëm i ligjit aktual për mbrojtjen e konkurrencës është e drejta e çdo personi që ti drejtohen drejtpërdrejt gjykatës në rast se pengohen në veprimtarinë e tyre nga një marrëveshje e ndaluar apo nga një praktikë abuzive. Sipas ligjit këta persona të mund ti drejtohet Gjykatës së Tiranës me anë të një kërkesë padie pavarësisht faktit të inicimit të një procedure pranë Autoritetit. Në këtë mënyrë palët e interesuara kanë dy mundësi: të ankohen para Autoritetit të Konkurrencës ose të ngrenë padi pranë Gjykatës së Tiranës.

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga:

- Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe
- Sekretariati, ekspertët të cilët realizojnë monitorimet dhe hetimet në treg

Kjo strukturë respekton ndarjen e funksionit të hetimit me atë të vendimmarrjes, e cila është dhe një kusht për një proces të pavarur dhe të paanshme në vendimmarrjet e Komisionit. Para marrjes së vendimit Komisioni fton për tu shprehur ndërmarrjet e hetuara, për të qenë sa më objektiv dhe profesional në këtë proces.

Parimet mbi bazën e të cilave realizohet ligji, politika kombëtare dhe veprimtaria e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, janë barazia, gjithë përfshirja, transparenca, përgjegjshmëria, besueshmëria, integriteti, bashkëpunimi.

Në zbatim të ligjit institucioni i konkurrencës ka të drejtën të marri çdo lloj informacioni nga ndërmarrjet dhe në rast nevojë mund të kryejë inspektime në mjediset e ndërmarrjeve të ndryshme, pa paralajmërim dhe në çdo kohë. Në rast se ndërmarrjet apo përfaqësues të tyre, pengojnë inspektimin apo fshehin të dhëna Autoriteti i Konkurrencës mund të vendosë gjoba deri në 1% të xhiros së realizuar nga ndërmarrja gjatë vitit paraardhës.

Në rast se Autoriteti i Konkurrencës gjen prova të shkeljes së ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, mund të vendosë gjoba në masën deri në 10% të xhiros së realizuar nga ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve gjatë vitit paraardhës. Për shembull, në rastet e pjesëmarrjes në një kartel për fiksimin e çmimeve apo për ndarjen e tregut.

Ç' ndodh nëse një ndërmarrje e madhe kërkon të nxjerrë konkurrentët nga tregu?

Nëse një ndërmarrje (ose një grup ndërmarrjesh) zotëron një pjesë të madhe të tregut, mund të thuhet që ka/kanë një pozitë dominuese në treg. Ndërmarrjet me pozitë dominuese, kanë fuqinë e nevojshme ekonomike që të veprojnë në atë treg pa qenë të kushtëzuar nga sjellja e konkurrentëve apo e konsumatorëve. Duke patur këtë fuqi tregu, ndërmarrja mund të abuzoj me këtë fuqi duke sjellë përfitime të paligjshme duke eliminuar konkurrencën si dhe duke ulur mirëqënien e konsumatorit. Për këtë arsye është shkelje e ligjit që të abuzohet me pozitën dominuese.

Duhet të kemi parasysh se zotërimi i tregut nga një ndërmarrje nuk është e ndaluar me ligjin shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës. Por abuzimi me këtë pozitë është rreptësisht i ndaluar.

Abuzimi mund të shfaqet në forma të ndryshme si:

- Vendosja e çmimeve shumë të larta në mënyrë të paarsyetuar duke zhvatur konsumatorët.
- Vendosja e çmimeve shumë të ulëta, nën kosto, që mund të çojnë në daljen nga tregu të ndërmarrjeve konkurruese apo duke penguar hyrjen në treg të konkurrentëve të rinj,
- Diskriminimi i ndërmarrjeve të tjera, për shembull duke refuzuar ofrimin e mallrave apo shërbimeve vetëm për disa ndërmarrje.
- Vendosjen e kushteve të padrejta të tregtimit për ndërmarrje të ndryshme p.sh. duke lidhur shitjen e një produkti të caktuar me kusht që të blihet vetëm së bashku me një produkt tjetër.

Abuzimi me pozitën dominuese

Neni 9 i Ligjit 9121 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, ndalon abuzimin me pozitën dominuese dhe aplikohet kur:

1. ndërmarrja ka një pozitë dominuese e cila vlerësohet duke marrë në konsideratë pjesët e tregut, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, pengesat e hyrjes në treg, lidhjet ekonomike të ndërmarrjes me ndërmarrjet e tjera, transparencën e tregut, etj.
2. ndërmarrja abuzon me pozitën e saj duke vendosur:
 - çmime të padrejta për klientët,
 - çmime shumë të ulëta në mënyrë që të pengojë hyrjen e konkurrentëve të rinj në treg ose të nxjerrë konkurrentët ekzistues nga tregu.

Autoriteti i Konkurrencës mund të ndalojë abuzimin me pozitën dominuese dhe të gjobisë kompanitë që abuzojnë me këtë pozitë.

Abuzimi me pozitën dominuese i ARMO-s

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 20 Korrik 2010 ka shqyrtuar çështjen me objekt “Ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të produktit lëndë djegëse diesel (D2)”.

Sjellja e ndërmarrjes ARMO SHA ka qënë objekt monitorimi nga Autoriteti i Konkurrencës kryesisht pas privatizimit. Në vijim të procedurave sipas Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, komisioni i Konkurrencës ka marrë vendim për hapjen e hetimit të thelluar me objekt ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë ARMO SHA në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të produktit lëndë djegëse diesel (D2) për periudhën 01 janar deri në 31 tetor 2009. Në bazë të këtij vendimi Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës “Raportin e hetimit të thelluar”.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në datën 10 qershor 2010, u organizua seanca dëgjimore ku pala nën hetim ka paraqitur pretendimet e saj mbi raportin e hetimit të thelluar.

Mbi bazën e vlerësimit të pozitës dominuese të ndërmarrjes ARMO SHA në lidhje me analizën e pjesës së tregut që zë kjo ndërmarrje në tregun përkatës lëndë djegëse diesel (D2) për makina dhe makineri, pengesave të hyrjes në treg, konkurrencës potenciale, fuqisë ekonomike të ndërmarrjeve, fuqisë kundërvepruese të blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut përkatës, ka rezultuar se kjo ndërmarrje për periudhën në hetim ka patur pozitë dominuese në tregun përkatës objekt hetimi.

Sipas evidencave të administruara ka rezultuar se ndërmarrja “ARMO” SHA, gjatë periudhës nën hetim ka zbatuar çmime dhe kushte të ndryshme tregtimi për veprime të njëjta tregtare me palët, duke vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence ndërmarrjet që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të produktit lëndë djegëse diesel D2.

Ndërmarrja “ARMO” SHA duke pasur një pozitë dominuese në tregun përkatës është e detyruar të zbatojë rregullat e sjelljes për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 8, nenin 9, pika 1, dhe pika 2 germa (c), nenin 74, pika 1, germa (a) dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi që për abuzimin me pozitën dominuese për periudhën 1 janar 2009 - 22 gusht 2009, në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2, ndërmarrja “ARMO: SHA të gjobitet në shumën 271,880,720 Lekë që përbën 2,6% të xhiros totale vjetore të vitit 2009.

Marrëveshjet e ndaluara

Marrëveshjet, midis ndërmarrjeve të cilat mund të sjellin kufizim të konkurrencës janë të ndaluara. Kështu, parimi që “marrëveshjet duhen respektuar” nuk aplikohet në këto raste. Autoriteti i Konkurrencës mund të urdhërojë ndalimin e marrëveshjeve të tilla dhe mund ti vendos gjoba ndërmarrjeve për arritjen e këtyre marrëveshjeve. Ky rregull zbatohet si për marrëveshjet e shkruara ashtu edhe për ato të pashkruara.

Një formë e marrëveshjes së ndaluar është karteli, i cili është një grup ndërmarrjesh të ngjashme, të pavarura nga njëra tjetra, të cilat bien dakord që të kontrollojnë çmimet, ndajnë tregjet apo sjellje të kësaj natyre, me qëllim kufizimin e konkurrencës. Pjesëmarrësit në kartel veprojnë vetëm në pjesën e tregut për të cilën kanë rënë dakord me të tjerët dhe nuk kanë nevojë që të sjellin produkte të reja apo shërbime më cilësore me çmime më konkurruese. Në këtë mënyrë, konsumatorët paguajnë më shumë për mallra apo shërbime më pak cilësore.

Për këtë arsye, kartelet janë të ndaluara nga e drejta e konkurrencës në Shqipëri. Për të njëjtat arsye, Autoriteti i Konkurrencës, i ngarkuar për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, mund të vendosë gjoba të rënda për ato ndërmarrje që përfshihen në kartel. Për shkak të gjobave të rënda ndërmarrjet pjesëmarrëse në kartel ruajnë sekretin me të gjitha mjetet, duke fshehur sa më mirë që munden provat përkatëse. Ligji ka parashikuar programe të lehtësimit nga gjobat për ato ndërmarrje që ndihmojnë në gjetjen e provave për kartelin. Në këtë mënyrë, ndërmarrja e parë që jep prova për ekzistencën e kartelit, do të përjashtohet apo lehtësohet nga gjoba edhe pse ka qene pjese e tij. Megjithëse në Shqipëri akoma nuk ka pasur raste të tilla, në vendet e Bashkimit Europian, kjo politikë ka qenë shumë e suksesshme.

8

Gjatë veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës janë vendosur gjoba të ndryshme për subjektet që janë gjetur në shkelje të ligjit. Këto gjoba janë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Civile.. Gjobat shkojnë në Buxhetin e Shtetit duke ndihmuar financimin e shpenzimeve publike e duke shkuar në favor të taksapaguesve. Por, më i rëndësishëm është efekti që sjell frika nga gjobat e larta që mund të vendosë Autoriteti i Konkurrencës, në masën deri në 10 % të xhiros së vitit paraardhës. Ky penalitet mund të jetë shumë më i shtrenjtë se sa përfitimet shtesë mund të ketë nga përfshirja në marrëveshje. Ky fakt mund të sjell frenimin e ndërmarrjeve për të marrë pjesë në kartel, duke parandaluar krijimin e tyre.

Por jo të gjitha llojet e marrëveshjeve midis ndërmarrjeve konsiderohen të ndaluara sipas ligjit. Përgjithësisht, marrëveshjet që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve jo-konkurrense apo atyre me pjesë të vogla në treg, janë të lejueshme. Gjithashtu, mund të ketë marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve rivale, të cilat synojnë përmirësimin e produkteve apo shërbimeve, zhvillimin e produkteve të reja, apo përmirësimin e metodave të reja për prodhimin e tyre. Këto marrëveshje mund të lejohen pasi kanë një efekt pozitiv për zhvillimin në favor të konsumatorit..

Për shembull, produkte të reja që mund të kërkojnë kosto shumë të larta për zhvillimin e tyre por që mund të prodhohen vetëm nëse disa ndërmarrje bashkojnë burimet e tyre për zhvillimin e këtyre produkteve. Pra Marrëveshjet për kërkimin e zhvillimin si dhe marrëveshjet për transferimin e teknologjive, nuk e shkelin ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Edhe marrëveshje të tjera që kanë si qëllim prodhimin e përbashkët, blerjen apo shitjen e përbashkët ose standardizimin, mund të jenë të lejueshme por duhet bërë një analizë e plotë e rrethanave dhe përfitimeve ekonomike nga këto marrëveshje.

Ndërmarrjet bëjnë marrëveshje çdo ditë: a janë ato të paligjshme?

Një formë e marrëveshjes së ndaluar është karteli, i cili është një grup ndërmarrjesh të ngjashme, të pavarura nga njëra tjetra, të cilat bien dakord që të kontrollojnë çmimet, ndajnë tregjet apo sjellje të kësaj natyre, me qëllim kufizimin e konkurrencës. Pjesëmarrësit në kartel veprojnë vetëm në pjesën e tregut për të cilën kanë rënë dakord me të tjerët dhe nuk kanë nevojë që të sjellin produkte të reja apo shërbime më cilësore me çmime më konkurruese. Në këtë mënyrë, konsumatorët paguajnë më shumë për mallra apo shërbime më pak cilësore.

Për këtë arsye, kartelet janë të ndaluara nga e drejta e konkurrencës në Shqipëri. Për të njëjtat arsye, Autoriteti i Konkurrencës, i ngarkuar për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, mund të vendosë gjoba të rënda për ato ndërmarrje që përfshihen në kartel. Për shkak të gjobave të rënda ndërmarrjet pjesëmarrëse në kartel ruajnë sekretin me të gjitha mjetet, duke fshehur sa më mirë që munden provat përkatëse. Ligji ka parashikuar programe të lehtësimit nga gjobat për ato ndërmarrje që ndihmojnë në gjetjen e provave për kartelin. Në këtë mënyrë, ndërmarrja e parë që jep prova për ekzistencën e kartelit, do të përjashtohet apo lehtësohet nga gjoba edhe pse ka qene pjese e tij. Megjithëse në Shqipëri akoma nuk ka pasur raste të tilla, në vendet e Bashkimit Europian, kjo politikë ka qenë shumë e suksesshme.

Gjatë veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës janë vendosur gjoba të ndryshme për subjektet që janë gjetur në shkelje të ligjit. Këto gjoba janë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Civile.. Gjobat shkojnë në Buxhetin e Shtetit duke ndihmuar financimin e shpenzimeve publike e duke shkuar në favor të taksapaguesve. Por, më i rëndësishëm është efekti që sjell frika nga gjobat e larta që mund të vendosë Autoriteti i Konkurrencës, në masën deri në 10 % të xhiros së vitit paraardhes. Ky penalitet mund të jetë shumë më i shtrenjtë se sa përfitimet shtesë mund të ketë nga përfshirja në marrëveshje. Ky fakt mund të sjell frenimin e ndërmarrjeve për të marrë pjesë në kartel, duke parandaluar krijimin e tyre.

Por jo të gjitha llojet e marrëveshjeve midis ndërmarrjeve konsiderohen të ndaluara sipas ligjit. Përgjithësisht, marrëveshjet që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve jo-konkurrente apo atyre me pjesë të vogla në treg, janë të lejueshme. Gjithashtu, mund të ketë marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve rivale, të cilat synojnë përmirësimin e produkteve apo shërbimeve, zhvillimin e produkteve të reja, apo përmirësimin e metodave të reja për prodhimin e tyre. Këto marrëveshje mund të lejohen pasi kanë një efekt pozitiv për zhvillimin në favor të konsumatorit. Për shembull, produkte të reja që mund të kërkojnë kosto shumë të larta për zhvillimin e tyre por që mund të prodhohen vetëm nëse disa ndërmarrje bashkojnë burimet e tyre për zhvillimin e këtyre produkteve. Pra Marrëveshjet për kërkimin e zhvillimin si dhe marrëveshjet për transferimin e teknologjive, nuk e shkelin ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Edhe marrëveshje të tjera që kanë si qëllim prodhimin e përbashkët, blerjen apo shitjen e përbashkët ose standardizimin, mund të jenë të lejueshme por duhet bërë një analizë e plotë e rrethanave dhe përfitimeve ekonomike nga këto marrëveshje.

Kartelet në Shqipëri

Sipas nenit 4 të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” mund të cilësohen si marrëveshje të ndaluara të gjitha ato marrëveshje që:

1. Fiksojnë çmimin e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi.
2. Kufizojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet.
3. Ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit midis konkurrentëve.
4. Zbatojnë kushte diskriminuese për kompanitë që nuk janë pjesë e marrëveshjes, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

Megjithatë, disa marrëveshje kufizuese midis kompanive janë të lejuara sepse ato mund të nxisin konkurrencën.

Një marrëveshje që përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme është e lejuar:

1. Përmirëson prodhimin ose shpërndarjen e të mirave ose promovon progres teknik ose ekonomik.
2. Pjesëmarrje më e drejtë e konsumatorëve në këtë përfitim.
3. Nuk përmban kufizime, jo te domosdoshme, të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse.
4. Nuk duhet të kufizojë ndjeshëm konkurrencën.

Marrëveshjet e ndaluara në tregun e importit të miellit

Autoriteti i Konkurrencës, duke pasur parasysh shqetësimin publik shprehur edhe përmes medias, lidhur me rritjen e çmimit të bukës gjatë vitit 2008, mori në konsideratë nivelin e konkurrencës në tregun e importit të grurit dhe prodhimin të miellit.

Gjatë periudhës së hetimit, Autoriteti i Konkurrencës ka kryer një sërë inspektimesh në ndërmarrje që veprojnë në këtë treg si dhe ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme publike për të siguruar të dhëna të nevojshme për këtë hetim.

Nga hetimi rezultoi se ndërmarrjet “Atlas” Sh.a dhe “Boja” Sh.a, nuk kanë konkurruar në tregun e importit të grurit dhe prodhimin të miellit. Këto ndërmarrje kanë koordinuar sjelljen për sa i përket përcaktimit të çmimeve të tregtimit të produkteve përkatëse, si dhe kanë ndarë burimet e furnizimit. Si pasojë e kësaj sjelljeje, këto ndërmarrje kanë aplikuar çmime të njëjta të shitjes së grurit për prodhimin e bukës. Këto dy ndërmarrje, kanë fuqi të ndjeshme në treg.

Kjo praktikë e bashkërenduar në zbatim të neneve 3, pika 4 dhe pikës 1, germa “a” dhe “c” të nenit 4 të Ligjit Nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është marrëveshje e ndaluar pasi pengon dhe kufizon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Marrëveshja e ndaluar është horizontale, pasi ndërmarrjet së bashku veprojnë në të njëjtin nivel tregu (në tregun e importit të grurit për bukë), dhe për shkak të integritetit vertikal të tyre, ka sjellë pasoja në tregun e shitjes së grurit dhe të prodhimit e shitjes së miellit për prodhimin e bukës.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi (me anë të vendimit nr. 125 dt. 14.10.2009, “Për kufizim të konkurrencës në tregun e importit të grurit dhe prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës”) që për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar të gjobisë ndërmarrjen “Bloja” Sh.a, në shumën prej rreth 38.5 milionë lekë, dhe ndërmarrjen “Atlas” sh.a në shumën prej rreth 27.8 milionë lekë.

Komisioni i Konkurrencës kishte konstatuar marrëveshjen e ndaluar ndërmjet këtyre ndërmarrjeve dhe kishte vendosur ndalimin e saj, me Vendimin Nr. 113 datë 19.05.2009 “Për ndalimin e marrëveshjes në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit midis ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “ Bloja” Sh.a”.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës (me anë të vendimit nr. 126 dt 14.10.2009 për “Mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës dhe rekomandimet përkatëse”) vendosi që të mbyllë hetimin ndaj ndërmarrjeve të tjera që veprojnë në treg pasi nuk u gjetën prova për shkelje të ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në mënyrë që të nxitet konkurrenca e lirë dhe efektive në tregun e importit të miellit dhe prodhimit të bukës, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar disa rekomandime që i drejtohen institucioneve të ndryshme publike.

Konkretisht Komisioni i ka rekomanduar Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që të rishikojnë praktikën e çmimeve të referencës si dhe të rivlerësimeve tatimore në tregun e importit të grurit, për efektet e mundshme që mund të sjellin në kufizimin e konkurrencës në treg. Komisioni i ka rekomanduar edhe Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar që të sigurohet se pasqyrat financiare të pasqyrojnë saktë dhe drejt gjendjen pasurore dhe situatën financiare të ndërmarrjeve “Atlas” Sh.a dhe “ Bloja” Sh.a, si dy ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në treg.

Kontrolli i përqendrimeve

Ndërmarrjet të cilat bashkohen (duke realizuar të ashtuquajturat përqendrime) mund të zgjerojnë tregjet duke i sjelle një avantazh konsumatorit, megjithatë disa nga këto operacione mund të ulin konkureshmërinë dhe të dëmtojnë konsumatorin.

Duke ndërthurur aktivitet e tyre, ndërmarrje të ndryshme p.sh. mund të zhvillojnë produkte të reja me efencë më të mirë ose të ulin kostot e prodhimit apo të shpërndarjes. Falë efikasitetit të ndërmarrjeve, konkureshmëria në treg rritet dhe në këtë mënyrë konsumatori përfiton produktet me cilësi më të mirë me çmim të njëjtë apo më të lirë. Megjithatë disa përqendrime mund të ulin konkureshmërinë në treg, zakonisht duke krijuar apo duke forcuar pozitën dominuese, e cila mund të dëmtojë konsumatorin duke rritur çmimet, dhe duke ulur kështu mundësinë e tij për të zgjedhur ose kufizimin e progresit teknik dhe teknologjik. Konkurrenca e lartë është një faktor që çon në bashkimin e ndërmarrjeve. Riorganizime të këtij lloji janë të lejueshme dhe të mirëpritura në masë të tillë që nuk cenojnë konkurrencën dhe për rrjedhojë rrisin konkureshmërinë dhe përmirësojnë nivelin e jetesës. Qëllimi i shqyrtimit të përqendrimeve është për të parandaluar efektet negative që mund të sjellë për konkurrencën.

Cilat janë përqendrimet të cilat shqyrtohen nga Komisioni i Konkurrencës?

Nëse kufiri i xhiros i ndërmarrjeve që marrin pjesë është më i madh se ai i përcaktuar në ligj, qoftë në nivelin ndërkombëtar ashtu edhe në atë vendor, atëherë përqendrimet e propozuara i notifikohen Komisionit të Konkurrencës për autorizim.

Në cilat raste ndalohen apo autorizohen përqendrimet ?

Te gjitha propozimet e përqendrimeve të cilat njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës shqyrtohen nëse mund të kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën efektive në treg. Nëse rezulton se përqendrimi nuk e cenon konkurrencën, ai autorizohet pa kushte.

Nëse Komisioni i Konkurrencës vërteton se përqendrimi i synuar mund të prishë konkurrencën, palët mund të ndërmarrin masa për të parandaluar këtë mundësi. Ato mund të ndërmarrin p.sh. të lëshojnë një pjesë të aktivitetit të tyre të ndërthurur apo ti japin licencën e një teknologjie të veçantë një operatori tjetër të tregut. Nëse Komisioni i Konkurrencës aprovon masat e marra, do të autorizojë përqendrimin me kushte për të siguruar që do të respektohet konkurrenca e lirë dhe efektive në treg duke mbrojtur interesat e konsumatorëve. Në vijim verifikon herë pas here që këto kushte të respektohen dhe Autoriteti mund të mund të ndërhyjë në rast se ato zbatohen.

Nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse nuk ndërmarrin masa për t'i kaluar këto pengesa, përqendrimet duhen ndaluar në mënyrë që të mbrohen ndërmarrjet e tjera dhe konsumatorët ndaj rrezikut të ngritjes së çmimeve dhe të zvogëlimit të mundësisë së zgjedhjes së të mirave dhe shërbimeve. P.sh një përqendrim mund të ndalohet nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse janë konkurrentët kryesorë në treg ose nëse do të dobësonte në mënyrë të ndjeshme konkurrencën efektive në treg, veçanërisht nëse forcon ose krijon një pozicion dominuese.

Vienna Insurance Group AG fiton kontrollin e Interbalkan Sh.a

Në mbledhjen e datës 23 Nëntor 2010, Komisioni i Konkurrencës shqyrtoi raportin mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75 % +1 të kapitalit aksionar me të drejtë vote të shoqërisë Interbalkan Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG. Përqëndrimi i realizuar konsiston në ndryshimin e kontrollit të shoqërisë Interbalkan Sh.a dhe shoqëria Vienna Insurance Group AG përfton kontrollin e vetëm në këtë të fundit nëpërmjet shit-blerjes së aksioneve.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit është ndryshim kontrolli në formën e ndryshimit të pronësisë dhe hyrjes së një aksioneri të ri kontrollues. Gjithashtu përqëndrimi i realizuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove(neni 12/1).

Pas realizmit të përqendrimit, struktura e tregut nuk ndryshon pasi në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b kemi zëvendësim të pronësisë dhe blerësi do të ruajë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e profilit tregtar të shoqërisë i Interbalkan Sh.a.

Nga Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit rezultoi se tregu i sigurimeve është një treg i rregulluar me dinamikë të lartë zhvillimi që karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në paketën kontrolluese të ndërmarrjeve prezente, kryesisht nga shoqëri sigurimesh nga vendet europiane.

Përqëndrimi I realizuar ka tregje të prekura pasi Viena Insurance Group zotëron paketën kontrolluese të aksioneve në shoqërinë Sigma sh.a. Për vlerësimin e efekteve të përqendrimit janë analizuar tregjet e prekura në tregun shqiptar të sigurimeve kryesisht në tre nën-tregje të sigurimeve të jo-jetës si tregu i sigurimeve motorike, tregu i sigurimit të pasurisë dhe tregu i sigurimit të shëndetit. Në rastin e përqendrimit VIG-Interbalkan Sh.a pjesët e kombinuara të tregut janë më pak se 40 % .

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk sjell krijimin apo fuqizimin e pozitës dominuese dhe nga analiza e tregjeve të prekura rezulton se grupi Vienna

Insurance do të zotërojë kontrollin në dy shoqëri konkurruese në nivel horizontal të tregut, Interbalkan Sh.a dhe Sigma sh.a, por nuk shfaqen shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75 % +1 të kapitalit aksionar me të drejtë vote të shoqërisë Interbalkan Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG.

Baza ligjore për kontrollin e përqendrimeve

Ligji nr. 9121 dt. 28.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullore “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzim “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë e njoftimit të thjeshtuar”

Komisioni i Konkurrencës ka kompetence ekskluzive për sa i përket kontrollit të përqendrimeve. Ky dimension përcaktohet në bazë të kufirit të xhiros vjetore të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që duhet të jetë mbi 7 miliardë Lekë në nivelin ndërkombëtar dhe 400 milionë Lekë në atë kombëtar. Përqendrimet në nivel kombëtar duhet të njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës për të marrë autorizimin përkatës nga Komisioni i Konkurrencës paraprakisht realizimit të tyre.. Ndërsa informacion më të hollësishëm për mënyrën e njoftimit dhe të formularit përkatës janë të përcaktuar në bazë të “Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe mund ti gjeni në adresën zyrtare Autoritetit të Konkurrencës në seksionin “Përqendrimë”. Komisioni i Konkurrencës autorizon përqendrimin brenda 2 muajsh nga data e njoftimit të tij ose nëse përqendrimi paraqet një pengesë të madhe për konkurrencën efektive në treg, mund të nisë një procedim për hetim të thelluar i cili zgjat zakonisht edhe 3 muaj të tjerë (që në rastin e autorizimit me kushte shkon deri në 5 muaj).

Komisioni i Konkurrencës ka miratuar paketën e përqendrimeve e cila përfshin:

1. Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve;
2. Udhëzim për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë e njoftimit të thjeshtuar, të cilat mund të konsultohen në faqen tonë zyrtare www.caa.gov.al.



Pyetje/Përgjigje mbi Autoritetin e Konkurrencës dhe veprimtarinë e tij

Çfarë nënkuptohet me shprehjen “Autoriteti është një institucion i pavarur administrativ”?

Autoriteti është institucion i pavarur publik, e cila sigurohet nga procedurat e përzgjedhjes së Komisionit (cdo komisioner zgjidhet me votim në parlament) dhe i raporton vetëm Parlamentit Shqiptar.

Anëtarët e Komisionit gëzojnë pavarësi personale, profesionale, si dhe pavarësi veprimi dhe gjatë ushtrimit të detyrave të tyre detyrohen vetëm të respektojnë kuadrin ligjor .

Kush legjitimohet të depozitojë pranë AK-së një ankesë për sa i përket shkeljeve të ligjit të konkurrencës?

Çdo Person fizikë;

Çdo Person juridikë

A konsiderohet paraqitja e ankesës nga një palë e interesuar si një kërkesë paraprake për fillimin e procedurave hetimore nga Autoriteti i Konkurrencës?

PO. Autoriteti i Konkurrencës mund të fillojë procedurat hetimore:

Me kërkesë të ndërmarrjeve të interesuara ose ne bazë të një ankese të të tretëve;

Me iniciativën e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës, me miratim të Komisionit;

Më kërkesë të Komisionit të Konkurrencës.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës mund të fillojë procedurat hetimore për shkelje të mundshme të ligjit edhe nëse nuk është depozituar ankesë apo kërkesë pranë zyrave të këtij institucioni.

Çfarë forme duhet të ketë ankesa?

Sipas Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” ankesat duhet të përmbajnë informacionin e kërkuar në një formë të veçantë dhe të miratuar nga Komisioni (sipas Formularin Tip me shkrim të ankesës). Por një ankesë mund të paraqitet edhe me gojë pranë Autoritetit të Konkurrencës. Një ankesë mund të dorëzohet në Autoritet edhe dorazi apo me postë elektronike. Autoriteti i Konkurrencës, merr në shqyrtim edhe ankesat anonime për çështje që janë në juridiksionin e institucionit.

Çfarë ndodh pas depozitimit të një ankese kundër një ndërmarrjeje të caktuar?

Me depozitimi e një ankese, Autoriteti i Konkurrencës merr në konsideratë këtë rast. Për fillimin e procedurave është e nevojshme që:

- Sekretariati/Drejtoria apo Sektori përkatës të kryejë një mbledhje të plotë të dhënash me qëllim që të përcaktojë nëse kemi një shkelje të mundshme ashtu siç është përshkruar në ankesë;
- Sekretariati/Drejtoria apo Sektori përkatës të kontaktojë me ndërmarrjen e dyshuar/nën hetim me qëllim që të mbledhë të dhëna dhe informacion.

Si mund të përligjet/mbështetur në prova një shkelje?

Me qëllim që të kryhen hetimet, inspektorët e Sekretariati , bazuar në një autorizim dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, mund të ndërmarrin veprime të tilla si:

- Të hyjnë në mjediset e ndërmarrjeve, gjatë orarit të punës;
- Të shqyrtojnë librat dhe regjistrat e veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe dokumentet e tjera, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së këtij dokumentacioni, në formë të shkruar ose elektronike;
- Të marrin ose të sigurojnë kopje ose pjesë nga këto libra, regjistra ose dokumente; të vulosin çdo seli, libër ose regjistër të veprimtarisë ekonomike për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për inspektimin;
- T'i kërkojnë çdo përfaqësues ose punonjësi të ndërmarrjes shpjegime për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Inspektorët e Autoritetit, të autorizuar me vendim nga gjykata që ka në juridiksion vendin ku kryhet kontrolli, mund të hyjnë në banesat e administratorëve, menaxherëve, drejtorëve dhe punonjësve të tjerë të ndërmarrjes, si dhe në banesat e selitë e veprimtarisë ekonomike të personave fizikë dhe juridikë, të brendshëm ose të jashtëm, të ngarkuar për menaxhimin tregtar, kontabël, administrativ, fiskal ose financiar kur ka arsye të bazuara për fakte dhe rrethana konkrete se në këto mjedise gjenden ditare ose dokumente të tjera profesionale.

Sipas konkluzioneve të nxjerra, hartohet një raport i cili i dorëzohet Komisionit të Konkurrencës, i cili është organi kompetent për të vendosur nëse shkelja është vërtetuar apo jo bazuar në prova. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nxirret pasi i jepet mundësia palëve për të shprehur pretendimet e tyre.

Si e vendos Komisioni i Konkurrencës nivelin e gjobave dhe të sanksioneve?

N.q.s Komisioni i Konkurrencës konkludon se ka pasur një shkelje, gjoba mund të jetë deri në 10% të xhiros totale të vitit financiar paraardhës për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse;

Në vendosjen e nivelit të gjobave, Komisioni i Konkurrencës merr në konsideratë rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer.

Janë të mbrojtura sekretet e biznesit të ndërmarrjeve gjatë procedurave hetimore?

Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 'Për Mbrojtjen e Konkurrencës' (Neni 30) parashikon një dispozitë të qartë për sa i përket mbrojtjes dhe ruajtjes së sekretit tregtar.

Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Sekretariatit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruara gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur duhet të dëshmojnë përpara gjykatës. Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës.

Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.

A garantohen të drejtat e ndërmarrjeve nën hetim gjatë procedurave hetimore?

Ndërmarrjet e përfshira mund:

- Të kenë akses në materialet jo-konfidenciale të dosjes, në mënyrë që të përgatisin mbrojtjen e tyre përpara marrjes së vendimit nga Komisioni i Konkurrencës.
- Të marrin pjesë në procedurat e rastit në shqyrtim duke shprehur pikëpamjet e tyre vetë ose nëpërmjet Avokatëve të tyre.
- Të shprehin me gojë pretendimet e tyre gjatë fazës së seancës dëgjimore.
- Të ankimojnë vendimin e Autoritetit të Konkurrencës pranë Gjykatës së Tiranës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit. Etj.

Vendimet e Komisionit të Konkurrencës njoftohen nga Sekretariati dhe publikohen në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës si dhe në Buletinin zyrtar të tij në numrin më të afërt.

A duhet Komisioni i Konkurrencës të kompensojë personat që mund të jenë dëmtuar nga veprimet anti-konkurruese të një ose disa ndërmarrjeve?

JO. Personat të cilët mund të kenë pësuar dëm si pasojë e veprimeve anti-konkurruese të një ose disa ndërmarrjeve mund të ngrenë padi në Gjykatën e shkallës së parë dhe të pretendojnë dëmshpërblimin.

Si mundet një ndërmarrje e cila ka qenë pjesë e një marrëveshjeje të fshehtë të përfitojë nga programi i lehtësimit të gjobës?

Duke bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës ndërmarrjet të cilat mund të japin informacione ose të dhëna për ekzistencën e një marrëveshjeje të fshehtë, në të cilën ata vetë kanë qenë pjesëmarrës, mund të kërkojnë imunitet nga gjoba dhe ose reduktim të gjobës.

Rregullorja për gjobat dhe lehtësimin e tyre paraqet të gjitha kushtet që duhet të plotësojë ndërmarrja që të përfitojë lehtësim nga gjoba. Komisioni mund të japë lehtësim nga gjoba në përpjesëtim me kontributin e dhënë për zbulimin dhe ndalimin e shkeljes.

A është e detyruar një ndërmarrje që të japë informacionin e kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës?

Po. Ndërmarrjet duhet të japin të gjithë informacionin e kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Nëse një ndërmarrje refuzon, krijon vështirësi ose vonon dhënien e informacionit të kërkuar, ose jep informacion jo të saktë, jo të plotë ose mashtrues, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjobe deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar.

A duhet të njoftohen marrëveshjet në Autoritetin e Konkurrencës?

Të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet nga shoqatat e ndërmarrjeve dhe praktikatat bashkërenduara, të cilat kanë për qëllim ose shkaktojnë kufizimin e konkurrencës, duhet të njoftohen nga ndërmarrjet pjesëmarrëse ose nga shoqatat e ndërmarrjeve në Komisionin e Konkurrencës.

Në rastin e mos njoftimit, Komisioni vendos gjobe deri në 10% të xhiros totale të vitit financiar paraardhës për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse.

Si njoftohet një marrëveshje?

Marrëveshjet njoftohen duke dërguar në Autoritetin e Konkurrencës një formë njoftimi (një formë e përcaktuar e cila gjendet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës www.caa.gov.al).

Kur një ndërmarrje ka detyrimin për njoftimin e një përqendrimi?

Një përqendrim duhet njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës, vetëm nëse përmbush kushtet e xhiros si më poshtë:

Të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim kanë një xhiro totale, në tregun ndërkombëtar, më shumë se 7 miliardë lekë, ose xhiro e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun e brendshëm, është më shumë se 400 milionë lekë; dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

Si njoftohet një përqendrim?

Përqendrimet njoftohen duke dërguar në Autoritetin e Konkurrencës Formularin e njoftimit (i cili është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Autoritetin të konkurrencës së bashku me udhëzimet përkatëse www.caa.gov.al).

Kur është i ndaluar një përqendrim?

Çdo përqendrim ndërmjet ndërmarrjeve ndalohet të realizohet kur:

Mund të pengojë ndjeshëm konkurrencën në tregun e brendshëm ose një pjesë të rëndësishme të tij, në lidhje me karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve dhe veçanërisht kur krijon ose forcon pozitën dominuese.

Para autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

Çfarë ndodh nëse një ndërmarrje pengon hetimin e Autoritetit të Konkurrencës?

Autoriteti i Konkurrencës mund të vendosë një gjobë deri në 1% të xhiros së ndërmarrjes që pengon hetimet e Autoritetit të Konkurrencës në çdo formë si p.sh duke penguar inspektimet Autoritetit të Konkurrencës në selinë e tij, japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese në përgjigje të kërkesave të Autoritetit të Konkurrencës, refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve për faktet, heqin vulat e vëna në autorizimin zyrtar të Autoritetit, etj.

Si mund ta arrijmë te Autoriteti i Konkurrencës?


Autoriteti i Konkurrencës mirëpret çdo person të interesuar që të drejtohet pranë mjediseve të Autoritetit të Konkurrencës, për çdo sqarim mbi veprimtarinë e këtij institucioni ose të kontaktojë me anë të postës elektronike apo telefonit.

Adresa:

Rr"Samë Frashëri"Nr4, kati4, Tiranë.
tel +35542234504; Tel/fax +355 42234497;
e-mail: competition@caa.gov.al

Kontaktet e tjera:

www.caa.gov.al
competition@caa.gov.al



FJALOR I SHKURTËR I KONKURRENCËS

Abuzimi me pozitën dominuese

Praktika biznesi anti-konkurruese (ku përfshihet shfrytëzimi i klientëve apo nxjerrja jashtë loje e konkurrentëve), që mund t'i përdorë një firmë me pozicion dominues për të ruajtur apo përforcuar pozicionin e vet në treg. Ligji i konkurrencës i ndalon praktika të tilla, sepse ato e dëmtojnë konkurrencën e vërtetë midis firmave, shfrytëzojnë konsumatorët dhe nuk nxitin konkurrencën e mbështetur në meritat e ndërmarrjes.

Kartelet

Marrëveshje midis firmave konkurrencte e cila hartohet për të kufizuar apo eliminuar konkurrencën midis tyre, duke pasur si objektiv rritjen e çmimeve dhe të fitimeve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse pa ofruar asnjë përfitim shtesë në të cilin të mbështetet kjo rritje. Në praktikë, kjo realizohet duke fiksuar çmimet, duke kufizuar prodhimin, duke bërë ndarje të tregjeve, të klientëve apo të territoreve, duke manipuluar tenderat ose duke kombinuar disa nga kufizimet e sipërpërmendura. Kartelet janë në dëm të konsumatorëve dhe të shoqërisë në përgjithësi për shkak të faktit që ndërmarrjet që marrin pjesë në to vendosin çmime më të larta (dhe marrin fitime më të mëdha) se sa në një treg konkurrues.

Konkurrenca

Një situatë në një treg në të cilën shitësit e një produkti apo shërbimi përpiqen në mënyrë të pavarur të tërheqin blerës për të arritur një objektiv të caktuar tregtar, për shembull, fitime, shitje dhe/ose pjesë të tregut. Rivaliteti konkurrues midis firmave mund të ekzistojë në terma të çmimeve, cilësisë, shërbimit, ose një kombinim i tyre dhe faktorëve të tjerë që mund të vlerësojnë klientët. Konkurrenca e lirë dhe e pa shtrembëruar është guri i themelit të një ekonomie tregu dhe Autoriteti i Konkurrencës ushtron kompetencat e nevojshme për të mbikëqyrur sjelljen e ndërmarrjeve që çenojnë konkurrencën si dhe kontrollin e akteve të ndryshme normative, për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Përqendrim

Përqendrimi ndodh kur bashkohen dy ose më shumë ndërmarrje të cilat më parë ishin të pavarura nga njëra tjetra (bashkim shoqërisë), ose kur një ndërmarrje fiton kontroll mbi një ndërmarrje tjetër (përfitim i kontrollit), ose kur krijohet një ndërmarrje e përbashkët e cila kryen në mënyrë të përhershme të gjitha funksionet e një subjekti ekonomik të pavarur (ndërmarrje e përbashkët me funksione të plota).

Pozicioni dominues

Një ndërmarrje ka një pozicion dominues nëse ka aftësinë për t'u sjellë në mënyrë të pavarur nga konkurrentët e saj, klientët, furnitorët dhe së fundi konsumatorët e saj përfundimtarë. Një firmë dominuese që ka një fuqi të tillë në treg ka edhe aftësinë për t'i vendosur çmimet mbi nivelin konkurrues, për të shitur produkte të një cilësie të ulët apo për ta ulur shkallën e novacionit poshtë nivelit që do të kishte një

treg në kushtet e konkurrencës. Sipas ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës, nuk është e paligjshme të kesh një pozicion dominues, duke qenë se një pozicion dominues mund të përfitohet me mjetet e ligjshme. Pozicionin dominues mund ta kenë së bashku edhe dy ose më shumë subjekte ekonomike të bashkuara përmes lidhjeve ekonomike në një treg specifik. Kjo situatë është quajtur dominancë kolektive (ose e përbashkët apo oligopolistike).

Pjesa e tregut

Matja e madhësisë relative të një ndërmarrjeje në një industri ose në një treg në terma të pjesës së produktit total, shitjeve ose kapacitetit gjithsej që zë kjo firmë. Përveç fitimeve, njëri prej objektivave tregtarë të firmave, që përmenden shpesh, është rritja e pjesës që zë në treg. Në analizat e politikës së konkurrencës, pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm për ekzistencën e fuqisë së tregut. Në lidhje me këtë, nuk duhet parë vetëm niveli absolut i pjesës i tregut, por edhe niveli i pjesës së tregut që zë në krahasim me konkurrentët. Megjithatë, edhe firmat që zënë pjesë të mëdha të tregut nuk kanë me domosdo fuqi tregu, sidomos në ato raste kur pengesat e hyrjes në treg (Pengesat e hyrjes) janë shumë të ulëta dhe rreziku i hyrjes së firmave të tjera e pengon ushtrimin e fuqisë e tregut.

Tregu përkatës

Përcaktimi i një tregu përkatës është një instrument për të identifikuar dhe përcaktuar kufijtë e konkurrencës midis firmave. Qëllimi kryesor i përcaktimit të tregut është identifikimi në mënyrë të vazhduar i kufizimeve të konkurrencës me të cilat përballen ndërmarrjet. Ndër të tjera, përcaktimi i tregut mundëson edhe llogaritjen e pjesës së tregut të ndërmarrjeve që janë aktive në tregun përkatës, që japin informacion të konsiderueshëm në lidhje me fuqinë e tregut në funksion të vlerësimit të dominancës (Pozicioni dominues). Një treg përkatës përcaktohet sipas faktorëve gjeografikë dhe të produktit. Në përgjithësi, një treg përkatës i produktit përfshin të gjithë ato produkte dhe/ose shërbime që konsiderohen si të këmbyeshëm ose zëvendësues (Zëvendësueshmëria) duke u mbështetur në karakteristikat, çmimet dhe përdorimin e produkteve. Duhet të merren në konsideratë edhe produktet dhe/ose shërbimet të cilat mund të hidhen në treg menjëherë nga prodhues të tjerë pa kosto të ndryshme të ndryshimit të destinacionit ose nga konkurrentët potencialë me kosto të arsyeshme dhe brenda një periudhe të kufizuar kohore.

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë të angazhuara në anën e ofertës dhe të kërkesës për produkte dhe shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe e cila mund të dallohet qartë nga zonat e tjera me të cilat kufizohet, sepse kushtet e konkurrencës ndryshojnë në mënyrë të dukshme nga ato të zonave të tjera

Program i lehtësimit

Term i përgjithshëm për eliminimin e plotë ose të pjesshëm të gjobave të aplikuara për firmat që bashkëpunojnë me autoritetet e konkurrencës për hetimet e karteleva.

Programi i tanishëm i masave lehtësuese është miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës me rregulloren “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.



KONKURRENCA NË SHQIPËRI - *Broshurë Informuese*

©Botim i Autoritetit të Konkurrencës. Nëntor 2011.

Adresa: Rr"Samë Frashëri"Nr4, kati4, Tiranë.

Tel +35542234504; *Tel/fax* +355 42234497;

E-mail: competition@caa.gov.al; *Web:* www.caa.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

KONKURRENCA NË SHQIPËRI

BROSHURË INFORMUESE